

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **205-26-1394-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar pune per stafin e Ministrise se Infrastruktures dhe Transportit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GALANTERIA SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ismail Qemali

(Adresa)

Podujevë

(Vendi)

049 945 949

(Numri Telefonit)

Nderim YMERI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

galanteriashpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

11000

(Kodi postar)

-

(Numri i Faks-it)

10.04.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)


(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Numri i faks-it)



(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit kemi të bëjmë me:

Për Aktivitetin e Prokurimit: 205-26-1394-5-5-8 Sa i përket tenderit për Furnizim me inventar pune për stafin e Ministrisë së Infrastruktës dhe Transportit

Qe është pjesë e Minitenderit të inicuar nga AQP.

Ftesa për tenderim është paraqitur me datë 18.03.2026 ndërsa është kërkuar ofertimi me datë 23.03.2026 (respektivisht 2 ditë pune të plota), vetëm data 19 dhe data 20.03.2026 ishin data të plota ndërsa data 18.03.2026 dhe data 23.03.2026 ishin në mes të orarit. Krahas kësaj Autoriteti Kontraktues ka kërkuar mostra dhe kriteri që janë relativisht të zorshme të gjinden dhe kjo ka bërë që në mënyrë automatike të favorizohet një Operator Ekonomik në këtë rast Wood Corporation SHPK.

1. Pse është favorizuar Wood Corporation SHPK është se kjo kompani njihet si një kompani që oferton me çmime të lira, dhe në rastin e Ministrisë së Infrastruktës çmimi i tyre ishte relativisht i lartë dhe ka një dallim vetëm 500 Euro me vlerën e parashikur. Pra, Wood Corporation ose i ka ditur kriteret paraprakisht, pasi që Dosje me kritere të tilla nuk lihet me afat aplimi 2 ditë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Nuk ka verejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

- ✓ Me datë 30.03.2026 kemi ngritur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Ministria e Infrastrukturës
- ✓ Me datë 02.04.2026 Autoriteti Kontraktues ka kthyer Përgjigjë në Kërkesën për Rishqyrtim – duke refuzuar Kërkesën tonë
- ✓ Sot me datë 10.04.2026 – Po paraqesim Ankesë pranë OSHP-së lidhur me: Aktivitetin e Prokurimit: 205-26-1394-5-5-8 Sa i përket tenderit për Furnizim me inventar pune për stafin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit i inicuar nga Ministria e Infrastrukturës.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligjin e Prokurimit Publik:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktivitetëve të prokurimit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës, ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik, REU I QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI, PËRJASHTIMET, PËRKUFIZIMET Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve

kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Duke e nderlidhur me Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi pasi qe kane shperblyer me kontrate nje Operator Ekonomik i pa pergjegjshem duke e demtuar Buxhetin e Republikes se Kosovës në vlerë financiare: 29275 Euro (pasi qe kane shperblyer me kontrate nje Operator Ekonomik) i cili nuk ploteson kushtet e vendosura ne Ftesen e Tenderimit.

Pretendimi 1.

Arsyeja e Eleminimit të Galanteria SHPK:

Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ju nek keni sjellu autorizimin sipas kërkesës se FPO me emër dhe nr te prokurimit, ISO:EN 16955:2017 eshte me afat te skaduar dhe mostrat e prezantuara nuk kan dimenzionet dhe specifikat sipas kërkesës FPO-se.

Pretendimi 1 – Kundërshtim ndaj arsyes së eliminimit të OE “Galanteria SHPK”

1. **Lidhur me autorizimin sipas kërkesës së FPO-së:** Arsyetimi për mungesë të autorizimit nuk qëndron, pasi ne posedojmë autorizim të përgjithshëm (gjeneral) nga kompania italiane COMPOTEC SRL (te ciles ju kane bashkangjitur detajet nga faqja Zyrtare e Korean Gas Spring që është Distributor për Europe), po ashtu ne kemi nje bashkepunim që nga viti 2003, i cili dëshmon bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm ndër vite. Ky autorizim i përgjithshëm përfshin të drejtën tonë për furnizim dhe përfaqësim, duke përmbushur në thelb kërkesën e FPO-së për autorizim.

Kthimi i përgjigjës nga Autoriteti Kontraktues:

Përgjigje e pretendimit 1:

1. Duke u bazuar ne kërkesat e FPO-se dhe dëshmitë e bashkangjitura ne ofertën tuaj autorizimi juaj është ne kundërshtim me kërkesën e autoriteti kontraktues meqë autorizimi edhe marrëveshja për produktet e ofruara është kërkuar te jene për këtë aktivitet te prokurimit. Ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 1 për Trajtim nga OSHP:

Kthimi i ketij pretendimi, i thatë dhe pa asnje përmbajtje ashtu sic ne e kemi detajuar qe jemi të autorizuar nga COMPOTEC SRL (duke I bashkangjitur faktet dhe argumentet nga faqja zyrtare) dhe duke e theksuar qe nga viti 2003 (23 vite) jo 23 ditë, 23 vite jemi përfaqesues të këtij brendi, dhe autorizimi është i përgjithem pasi qe ne jemi distributor për Republikën e Kosovës. **Tregon saktë se pretendimi i jone është i bazuar. Si mund të paraqesim një autorizim për 1 aktivitet, ku ne kemi autorizim të përgjithshem mbi shitjet. Logjika e Autoritetit Kontraktues është e nje anshme, tendencioze dhe pa asnje arsyeje, ngjashem edhe elininimimi. Paraqesim para Ekspertit Shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues të Prokurimit, se kur ekziston Autorizim I përgjithshem (shitje e pakushtezuar e artikujve) pse duhet te kete autorizim te vecante dhe per vetem nje aktivitet.**

2. **Lidhur me certifikatën ISO EN 16955:2017:** Pretendimi se certifikata ISO EN 16955:2017 është e skaduar nuk është i saktë, pasi e njëjta është valide deri më 24.04.2029, gjë që vërtetohet edhe nga dokumentacioni i bashkëngjitur dhe verifikimi në burime zyrtare. Rrjedhimisht, ky kriter është përmbushur plotësisht dhe nuk mund të shërbejë si bazë për

eliminim.

Gültig bis: Date of expiry:	2029-04-24
Gültig ab: Valid from:	2024-04-25
Ausstellungsdatum: Date of issue:	2024-04-24

Kthimi i përgjigjës nga Autoriteti Kontraktues:


2. Pretendimi juaj për ISO EN 16955:2017: është me validitet 24.04.2029 dhe merret i bazuar.

Nuk kemi pretendim ankimor mbi piken 2, me ne fund Autoriteti Kontraktues e ka kuptuar që Date of expiry (është data e skadimit), dhe se certifikatat nga vendet e ndryshme leshohen (Viti, Muaji dhe Data).

3. **Lidhur me mostrat dhe përputhshmërinë me specifikat teknike:** Pretendimi se mostrat nuk i përmbushin dimensionet dhe specifikat e kërkuara nuk qëndron, pasi produktet e prezantuara jo vetëm që i plotësojnë, por në disa raste i tejkalojnë kërkesat minimale. Për shembull, baza e ulëses është kërkuar 50.5 cm, ndërsa ne kemi ofruar 51 cm, dhe në asnjë rast dimensionet apo karakteristikat nuk janë më të ulëta se ato të kërkuara, por janë në përputhje ose më të favorshme. Paraqesim se gjate qasjes ne dokumente zyrtare, i kemi "matur" mostrat e WOOD Cooperation SHPK, dhe se te njejtat kane pas divergjencat (dallimet) me dallimet tona. Gjate qasjes ne dokumente zyrtare, kemi paraqitur edhe detajet se produktet tona jane me prejardhje nga Italia dhe se detajet e mbështetjes ne koke, mbështetjes ne dore, kembet dhe rrjeta jane relativisht me te largeta se sa ato se cfare i ka paraqitur Operatori Ekonomik perfutues.

Kthimi i përgjigjës nga Autoriteti Kontraktues:

3. Kurse mostrat që keni prezantuar nuk janë sipas specifikave teknike dhe nuk është kërkuar te tejkalohej madhësia e kërkuar te bashkangjitur gjeni fotot ku për pozicionin nr.4 pjesa e duarve duhet të jetë e shkëputur nga pjesa e shpinës apo mbështetëses, mbështetëse krahu PP nga korniza e kromit kurse mostra juaj pjesën e duarve e ka nga plastika shih foton. Ky pretendim është i pa bazuar.



Pretendimi ankimor 2 për Trajtim nga OSHP:

Kerkoje nga ana e Panelit dhe Ekspertit trajtimin specifik (matjet ne vend, fotografite dhe ekzaminimin lidhur me produktin), e meta kryesore e kesaj pergjigje eshte se ai krahason Produktin tone me produktin e kompanise fituese dhe jo me specifikimet teknike. Ai ka vendosur 2 fotografi me nga 2 produkte, duke i krahasuar produktet tona me produktet e WOOD Cooperation SHPK. Pra, ketu nuk kemi te bejme me matjen e specifikave por me matjen mes

produkteve. **Paraqesim para panelit shqyrtues, se e vetmja diskrepance ne mes asaj se cfare ka kerkuar Autoriteti Kontraktues dhe asaj se cfare ne kemi dorezuar, është CILESIA ME E LARTË.** Ne asnje forme he ne asnje menyre nuk krahasohet cilesia e produktit tone me produktin e perzgjedhur fitues. Pra, neve na ka eliminuar per dick ate pabaze, ndersa WOOD Corporation e ka shpallur fitues ani pse gjate matjeve tona ne qasjen ne dokumente zyrtare verehet se produkti eshte me i vogel se sa ai ne specifikime teknike.

Lidhur me arsyet e elinimimit tone, asnjera nga keto pika nuk qendron, e para Autorizimet nga prodhuesi dhe nga distributori jane ne perputhje te plote me kerkesen tuaj. E dyta, certifikata eshte me afat dhe e treta, specifikat vetem se i tejkalojne kerkesat tuaja dhe ne asnje forme te njejtat nuk jane me te dobeta se cfare keni kerkuar (sikur te kishit nje pretendim te njejtin do te paraqisni ne Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues).

Pretendimi 2.

PINO SHPK nuk ka paraqitur asnje dokument të vetem që është prodhues dhe as distributor.

AUTORIZIM

Për: Ministria e Infrastruktures

- Numri i prokurimit: 205-26-1394-5-5-8
- Titulli i prokurimit: Furnizim me inventar pune per stafin e Ministrise se Infrastruktures dhe Transportit

Kompania PINO SH.P.K. me seli ne Prishtine , me Nr unik te biznesit: 810818966, përfaqësuar nga Artan Ymeri- drejtor, autorizon kompanine WOOD CORPORATION LLC me seli ne Suhareke me nr unik te biznesit 811289562 që të ofertoj për projektin në fjalë dhe nëse shpallet fitues të implementoj projektin e lartëcekur në pajtim me kërkesat e AK në dosjen e tenderit per pozicionet 4 dhe 8.

Si është e mundur, që PINO SHPK të Autorizoi Wood Corporationin për nje produkt qe nje asnje forme as nuk është prodhues e as distributor i asnje prodhuesi sipas produkteve 4. **Karrikë statike për Tavolinen e takimeve per 4 persona dhe 8. Karrikë lëvizëse me rrota.**

Pra, ne asnje rresht te Autorizimit nuk theksohet se nga kush eshte i autorizuar PINO.

Per te ju bindur qe PINO nuk është as prodhues, as distributor i asnje nga produktet e kerkuara nga ana e Ministrise se Infrastruktures, ne asnje rresht ne Fajllin 8 Certifikimet, Testimet dhe Standartet e prodhuesit nuk thekson qe PINO është i autorizuar ose distributor (ngjashem sic e kemi ne ne faqen Zyrtare te Korean Gas Spring) ku precizon qe Distributor per Evrope eshte COMPOTEC SRL Italy. Ne njeren ane thekson autorizim nga PINO ne anen tjeter paraqet se te gjitha produktet do te prodhohen ne Wood Corporation SHPK (pasi qe vet eshte prodhues).

Bazuar ne kontrollat ne internet: Changzhou TSR Gas Spring Co., Ltd. Nuk ka asnje perfaqesues as PINO SHPK, e as Wood Cooperation SHPK, ne kete forme te njejtit nuk e plotesojne kriterin: f.

OE duhet të ketë dhe dorëzoi autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar për artikujt 4 dhe 8, **si dhe operatorët që nuk janë prodhues të inventarit, duhet të sjellin edhe marrveshjen me prodhuesin për produktet e inventarit për këte aktivitet të prokurimit. Pra, te njejtit nuk kane paraqitur asnje dokument qe jane te autorizuar nga prodhuesi.**

Gjate qasjes ne dokumente zyrtare, perfaqesues te kompanise Galanteria SHPK kane realizuar matjet e produktit 4 dhe 8 sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktues, dhe se mostrat e dorezuara (qe ne i kemi edhe me foto) nuk jane mostra ne perputhje me specifikat e kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Çmimet e vendosura nga ana e Wood Cooperation SHPK janë relativisht te larta, shembull 1650 Euro për 1 meter të kuzhines, tavoline te vogel rreth 180 euro, rreth 190 euro nje kasete levizese me 4 fioka, produkti 12 ka nje çmim 5450 euro abnormalisht I larte kur flitet se kemi te bejme me 220cmX100cm te punuar nga MDF 48cm (rreth 8 here me e larte se sa oferta e jone), tavolinen e produktit 13 qe ne kemi ofertuar me 560 euro, ka ofertuar me 3850 euro, rreth 7 here me e shtrejt se sa oferta e jone.

Paraqesim se synimet jane te qarta, demtimi i Buxhetit rreth 30,000.00 Euro per te eliminiuar nje kompani si Galanteria SHPK e cila ka synimin e vetem paraqitjen e cilesise dhe realizimin me kohe te kontratave.

Kthimi i përgjigjës nga Autoriteti Kontraktues:

Përgjigje e pretendimit 2:

Operatori ekonomike ka prezantuar autorizimin sipas kërkesës se FPO-se dhe produktet e sjelluar (dorëzuar si mostër) ne autoritet mbajnë tiketën PINO sipas autorizimit te bashkangjitur ne dosjen e tenderit shih fotot e bashkangjitura ku produktet mbajnë tiketën PINO.



Kurse pretendimi juaj si OE i papërgjegjshëm se çmimet e ofruara nga OE fitues dëmtojnë buxhetin nuk qëndron meqë nuk tejkalon planifikimin e autoritetit kontraktues dhe mundësia qe te ofrojmë procedure te hapur nuk lejohet meqë OE konkurrues janë te caktuar sipas marrëveshjes kornize te lidhura OE me AQP-ne. Bazuar ne ligjin dhe rregulloren për prokurim publike duhet te jene minimumi 3 operatore ekonomike te përgjegjshëm qe te zbatojmë nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te RRPP-se. Ky pretendim është i pa bazuar.

Andaj, bazuar ne pretendime e larte cekuar dhe përgjigje e AK, edhe pse njeri nga pretendimet merret i bazuar rezultati me rivlerësim nuk do të ndryshohet për këtë aktivitet, pasi qe oferta e juaj është e pa përgjegjshme ne pikat e tjera të eliminimit dhe pretendimeve ankimore.

Pretendimi ankimor 3 për Trajtim nga OSHP:

Ankesë e paraqitur nga Galaneria SHPK Për Aktivitetin e Prokurimit: 205-26-1394-5-5-8 Sa i përket tenderit për Furnizim me inventar pune për stafin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit i inicuar nga: Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

“duhet të analizohet në detaje” – vendosja e një TIKETE (e në faktë është etiketë) nga një brend nuk i jep asnjehere të drejtën që quhet prodhues, mjafton të futesh në linkun www.pinomobile.com dhe të karriga që e kanë prezantuar si moster nuk ka fare etikete (shiko fotot):

	
<p>Dallimi në fotos zyrtare në web-faqe është se fotot janë marrë nga katalogu zyrtar i prodhimit të kësaj karrige dhe nuk kanë mundur të vendosin etiketat.</p>	<p>Kurse rasti i prezantimit të mostrave, kemi të bëjmë me vendosjen e etiketes vetem sa për këtë dosje tenderi, ose sa për të vendosur në lajthitje bleresit potencial apo edhe Autoritetet Kontraktuese.</p>
	

Ne mund te paraqesim fakte dhe argumente te mjaftueshme, qe ne Kosove ka dhjetra kompani qe prodhojne etiketa per kompani te mobilerise, etiketa nga metali dhe materialet e buta. Por, kjo nuk do te thot qe jane prodhues dhe as nuk jane te autorizuar te shesin nje produkt te tille. Kthimi i pergjigjes nga Autoriteti Kontraktues qe ne etikete shkruan PINO dhe ka nje autorizim, pa e verifikuar as te pino, e as kudo tjeter perbene shkelje ligjore, pasi qe Autoriteti Kontraktues eshte autoritet verifikues i dokumentave te dorezuara (nese jo vet, duhet te kerkoi sqarime konkrete).

Sipas logjikes se Ministrise se Infrastruktures, Wood Cooperation SHPK dhe kompanise tjeter e cila nuk eshte pjese e gares por qe ka autorizuar produktet per shitje, ne ne te ardhmen mund te pregaditisim nje Etiketete te "**Herman Miller**" dhe/apo "**Vitra**" ose te kompanive prestigjoze tjera boterore qe prodhojne inventar zyreje (karrige dhe sofa) qe nje karrige e tyre kushton 2000/6000Euro+ dhe ti vendosim ne karriget qe shesim ne (ne jemi prodhues te tyre). Kjo nuk qendron dhe nuk duhej te qendronte. Por se kjo qendron eshte fakti qe oferta e WOOD Cooperation është për 30% me e lartë se sa oferta e jonë dhe se Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar pa asnje baze ligjore, as kthimin e pergjigjes mbi shqyrtimin e kerkeses nuk e ka bere duke u thirrur se paku ne nje nen te Ligjit apo rregullores.

Kerkojme nga ana e ekspertit shqyrtues te trajtohet ky pretendim i detajuar, te analizoi tregun dhe te shikoi detajet:

"Çmimet e vendosura nga ana e Wood Cooperation SHPK janë relativisht te larta, shembull 1650 Euro për 1 meter të kuzhines, tavoline te vogel rreth 180 euro, rreth 190 euro nje kasete levizese me 4 fioka, produkti 12 ka nje çmim 5450 euro abnormalisht I larte kur flitet se kemi te bejme me 220cmX100cm te punuar nga MDF 48cm (rreth 8 here me e larte se sa oferta e jone), tavolinen e produktit 13 qe ne kemi ofertuar me 560 euro, ka ofertuar me 3850 euro, rreth 7 here me e shtrejt se sa oferta e jone".

Pra, nje meter e nje kuzhine ne Republiken e Kosoves nuk kushton 1650 Euro, nje tavoline e cila duhet te punohet nga 48mm (4.8cm) trashesi me dimensionet 220x100 (pra, 2.2m2 MDF) Ministria e Infrastruktures eshte duke e paguar 5450 Euro apo me mire te themi 2475 Euro për 1 meter katror tavoline, ose produkti 13 është 7 here me I lartë se sa oferta e jone. Sipas ZPP ne Ministrine e Infrastruktures Buxheti nuk eshte duke u demtuar pasi qe Wood Cooperation SHPK eshte nen Kuadratin buxhetor te vleres se parashikuar (duke harruar se cmimi i ofertes sone e pergjegjshme deri ne detajet e fundit eshte 30 mije euro me i lire).

I propozojome panelit shqyrtues dhe Ekspertit të lendes:

- ✓ Kthimin e lendes në Rivleresim
- ✓ Anulim të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk kemi në këtë fazë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- a) *I gjithë dokumentacioni eshte ne platforme.*